



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 31/5 prot.

Tiranë, më 31.1.2023

**Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 598, datë 13.12.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Genci Mane

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese.

**Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

**Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese;

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 16.1.2023, është njoftuar vendimi nr. 598, datë 13.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Genci Mane, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 598, datë 13.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

#### **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, z. Genci Mane, prej vitit 2005, ushtron detyrën e prokurorit dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

**2.** Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Genci Mane ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria

kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

**2.1.** ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Genci Mane*<sup>1</sup>”, ka referuar për subjektin, se:

- i. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**2.2.** DSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës ka referuar: “*Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Genci \*\*\* Mane*”.

**2.3.** KLP-ja, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Mane, ka hartuar një raport të hollësishëm, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

**3.** Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

**3.1. Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka hetuar dhe vlerësuar gjendjen pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: [...] *ka kryer deklarim të mjaftueshëm dhe, në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke konstatuar pasaktësi të karakterit minimal [...], subjekti i rivlerësimit justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato cash) dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin e prokurorit [...]*<sup>2</sup>.

**4. Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e përgatitur nga DSIK-ja, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: [...] *ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...]*<sup>3</sup>.

**5. Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka analizuar raportin e përgatitur nga KLP-ja, burimet arkivore dhe vlerësimin e denoncimeve nga publiku, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka arritur në përfundimin se: [...] *ka arritur nivel kualifikues në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...]*<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.3.2018.

<sup>2</sup> Për më tepër referohuni në f. 43, të vendimit të Komisionit.

<sup>3</sup> Për më tepër referohuni në f. 43, të vendimit.

<sup>4</sup> Për më tepër referohuni në f. 43, të vendimit.

**6. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Genci Mane, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier.*

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**7.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**8.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit (në vijim referuar si Kolegji).

**9.** Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

**10.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

**11.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 598/2022, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenueshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

**12.** Sa më sipër, bazuar në kërkesat e dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm nr. 84/2016, konstatohet se përfundimet e arritura nga Komisioni nuk janë të drejta dhe në pajtueshmëri me provat e administruara.

**13.** Për këto arsye, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 598, datë 13.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

### **III.A. Për kontrollin e pasurisë**

**14.** Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

**15.** Nga aktet e administruara dhe përmbajtja e vendimit të Komisionit, rezulton se gjatë hetimit administrativ të kriterit të pasurisë, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime

dhe i është kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi janë konstatuar problematika mbi saktësinë, mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

**16.** Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në: “*Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie*”, për vitin 2003<sup>5</sup>, dhe në vijim në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën “*Vetting*” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën 23.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatojmë se:

### **17. Pasuria apartament me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, qyteti Fier**

**17.1.** Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Banesë me sip. 140 m<sup>2</sup> në L. \*\*\*, Fier + 15 m<sup>2</sup> sip. e përbashkët.* Burimi i krijimit: *Kredi në Bankën \*\*\*\* \*\*\*, në shumën 2.900.000 lekë. Deklarata noteriale për shitjen e pjesës takuese, banesë e përbashkët ndodhur në L. \*\*\*, Berat, të pasurisë me nr.\*\*\*, sip. 82 m<sup>2</sup> dhe \*\*\*, sip. 57 m<sup>2</sup>, në shumën 1.700.000 lekë dhe kursimet nga paga. Vlera: 4.650.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

**17.2.** Në DV-2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pagesa e këstit të parë në kontratën e shitjes së sendit në të ardhmen për blerjen e një apartamenti në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, në shumën 4.650.000 lekë, datë \*\*.9.2009, nr. \*\*\* rep., dhe nr.\*\*\* kol., datë \*\*.9.2009. Vlera 100.000 lekë.* Pjesa takuese nuk deklarohet.

**17.3.** Në DV-2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartment banimi në L. \*\*\*, Fier, sip. 140 m<sup>2</sup> + sip. e përbashkët 15 m<sup>2</sup>.* Burimi i krijimit: *Kredi në Bankën \*\*\*\* \*\*\*, në shumën 2.900.000 lekë. Shitje e pjesës takuese, banesë e përbashkët ndodhur në L. \*\*\*, Berat, të pasurisë me nr.\*\*\*, sip. 82 m<sup>2</sup> dhe \*\*\*, sip.57 m<sup>2</sup>, në shumën 1.700.000 lekë. Vlera: 4.650.000 lekë.* Pjesa takuese nuk deklarohet.

**17.4.** Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Fier, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2022, konfirmon pasurinë “apartment” me sip. 155 m<sup>26</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në Fier, në bashkëpronësi të Genci e \*\*\* Mane. Burim krijimi i kësaj pasurie rezulton kontrata e shitjes me kusht kreditimi nga banka, me nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\* kol., datë \*\*.2.2013, me palë shitëse shoqëria “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k. dhe palë blerëse Genci \*\*\* Mane, përkundrejt çmimit kontraktor 4.650.000 lekë, çmim i cili do të lëvrohej në këtë mënyrë, kësti i parë 1.750.000 lekë, paguar nga pala blerëse para nënshkrimit të kontratës, kësti i dytë 2.900.000 lekë, përmes një kredi bankare të miratuar nga *Bankën \*\*\*\* \*\*\*, në favor të palës blerëse dhe disbursuar ekskluzivisht në llogarinë bankare të shitësit.*

**17.5.** Në vlerësim të saktësisë së deklarimit dhe burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, nga hetimi administrativ i Komisionit, kanë rezultuar faktet si më poshtë:

**17.5.1. Lidhur me shumën 1.700.000 lekë,** subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimi i krijimit të kësaj shume është shitja e pjesës takuese të banesës së përbashkët të familjes së origjinës, ndodhur në qytetin e Beratit, privatizuar në vitin 1993, si dhe ka paraqitur deklaratën noteriale nr.\*\*\* rep. dhe nr. \*\* kol., datë \*\*.2.2013. Me anë të kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit premtonte t’i kalojë pjesën e tij takuese në mënyrë të barabartë prindërve të tij, kundrejt vlerës 1.700.000 lekë, shumë e cila deklarohet se është marrë në dorëzim në datën e lidhjes së kësaj marrëveshjeje. Lidhur me mundësinë e prindërve të tij për t’i dhënë shumën 1.700.000 lekë, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar<sup>7</sup>: [...] *\*\*\*\* Mane ka qenë i*

<sup>5</sup> Deklaruar në cilësinë e Oficerit të Policisë Gjyqësore.

<sup>6</sup> Lloji i pasurisë *apartment* me sipërfaqe ndërtimore 140 m<sup>2</sup> (plus sipërfaqe të përbashkëta 15 m<sup>2</sup>), gjithsej 155 m<sup>2</sup>.

<sup>7</sup> Referohuni përgjigjeve të pyetësorit, datë 5.7.2022.

*punësuar pranë shoqërisë ‘\*\*\*’ për periudhën shtator 2007 – nëntor 2012, ku ka realizuar të ardhura në shumën prej 3,985,000 lekë. Përveç këtyre të ardhurave të realizuara nga puna, prindërit trajtoheshin edhe me pension [...]. Ndërsa i pyetur nga Komisioni lidhur me blerjen e ndonjë pasurie nga prindërit e tij, subjekti ka deklaruar<sup>8</sup>: Nga komunikimi me nënën ... më ka vënë në dispozicion Kontratë Sipërmarrje të datës \*\*.3.2004, për porositjen e një apartamenti ndodhur në rrugën “\*\*\* \*\*”, Tiranë, për të cilën është paguar me mandat arkëtimi nr. \*\*, datë \*\*.3.2004, shuma 61.946 euro. Bashkëlidhur pyetësorit, subjekti ka depozituar: (i) Kontratën e Sipërmarrjes datë \*\*.3.2004, me anë të së cilës shtetasit \*\*\* dhe \*\*.\*\*\*, prindërit e subjektit, kanë porositur nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., me administrator z. \*\*.\*\*\* një apartament me sipërfaqe 112.63 m,<sup>2</sup> kundrejt çmimit 61.946 euro ose 76.193 USD. (ii) Mandat arkëtimi nr. \*\*, datë \*\*.3.2004, për shumën 61.946 euro.*

**17.5.2. Lidhur me shumën 2.900.000 lekë,** me burim kredi në Bankën \*\*\* \*\* nga informacioni i administruar në dosje të Komisioni rezultoi se, në datë \*\*.4.2013, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë kredie bankare nr.\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., me Bankën \*\*\* \*\* për shumën 2.900.000 lekë. Kontrata është lidhur bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, të ndryshuar, VKM-ja nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve publikë”, udhëzimeve të Ministrisë së Punëve Publike dhe Ministrisë së Financave. Disbursimi i kredisë në shumën 2,900,000 lekë është bërë në datën \*\*.5.2013 dhe në datën \*\*.5.2013 është transferuar shuma 2.860.000 lekë, me përshkrimin: “Sa kaluar nga Genci Mane për likuidimin e blerjes përfundimtare të apartamentit në favor të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k”.

**17.5.3. Lidhur me burimin tjetër, kursime nga pagat,** të deklaruar në D-Vetting, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar ndonjëherë kursime *cash* në deklaratat periodike vjetore. Prandaj, si kursime nga pagat, mund të shërbejnë vetëm të ardhurat nga pagat e marra deri në momentin e pagesës së datës \*\*.2.2013.

**17.5.3.1.** Sa i takon vlerës së paguar në datën \*\*.2.2013, referuar kontratës së shitblerjes së pasurisë, palët pranojnë se kësti i parë prej 1.750.000 lekësh është paguar para nënshkrimit të kontratës. Ndërkohë, subjekti ka deklaruar në DV-2009 se ka paguar shumën 100.000 lekë në këtë vit, për apartamentin. Bazuar në këto rrethana, Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit për të paguar shumën e mbetur prej 1,650,000 lekësh në vitin 2013, pa përfshirë në analizë shumën e dhënë nga prindërit, 1.700.000 lekë. Nga analiza financiare e kryer deri në datën \*\*.2.2013, subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri për pagesën e vlerës prej 1.650.000 lekë për blerje apartamenti, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën sipas burimeve të deklaruara.

**17.5.4. Lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie,** në raport me çmimet e përcaktuara për ndërtimet në qytetin e Fierit, bazuar në udhëzimin nr.1, datë 20.8.2008, të Këshillit të Ministrave, rezultoi se vlera e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Fierit është në vlerën 55.062 lekë/m<sup>2</sup>. Bazuar në këto të dhëna, vlera e apartamentit të blerë nga subjekti i rivlerësimit llogaritet në vlerën 8.534.610 lekë, ndërsa subjekti e ka blerë këtë pasuri në vlerën 4.650.000 lekë, pra më pak se vlera e tregut.

**17.5.5. Lidhur me banimin në qytetin e Fierit,** subjekti, z. Mane, deklaroi<sup>9</sup> se në vitin 2009, ka transferuar gjendjen civile në qytetin e Fierit, ku prej vitit 2010 e në vazhdim banon në banesën ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Fier, të blerë prej tij dhe bashkëshortes, ndërsa familja ka filluar të banojë prej vitit 2011.

<sup>8</sup> Referohuni përgjigjeve të pyetësorit, datë 20.9.2022.

<sup>9</sup> Referohuni përgjigjeve të pyetësorit standard.

**17.5.6. Lidhur me shërbimet utilitare,** furnizim me energji elektrike dhe ujësjellës-kanalizime, rezulton e administruar vetëm përgjigjja<sup>10</sup> e Furnizuesit të Shërbimit Universal, ku konfirmohet se në instancën Fier, referuar të dhënave të sistemit të faturimit identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. \*\*\*, me gjeneralitetet Genci \*\*\* Mane dhe një abonent me kontratë furnizimi nr. \*\*\*, me gjeneralitetet Genci Mane. Komisioni nuk i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit.

**17.6.** Me aktin “Rezultatet e hetimit për subjektin e rivlerësimit”, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, lidhur me këto konstatime: (i) Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për krijimin e të gjithë shumës prej 1,700,000 lekë nga prindërit e subjektit, shumë e cila ka shërbyer si burim për pagesën e kështit të apartamentit me sip.140 m<sup>2</sup>; (ii) Trajtim preferencial në dukje (subjekti i rivlerësimit ka jetuar në apartament për 3.5 vjet, përpara se të paguante çmimin e plotë, mund të duket se ka dallime në afatin e dhënies së kësteve midis dy kontratave, çmimi i paguar i apartamentit është më i lartë se ai i tregut); (iii) Mungesa e të ardhurave të ligjshme në vlerën 1,650,000 lekë, për pagesën e kështit të banesës në vitin 2013; (iii) Dyshime për deklaratë noteriale fiktive ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe prindërve, pasi nuk rezulton: asnjë transaksion i gjurmueshëm, pagesa është bërë *cash*, pronësia nuk iu kalua asnjëherë prindërve të tij, babai nuk kishte të ardhura të ligjshme për shumën 1,700,000 lekë<sup>11</sup>, pjesa e transferuar e subjektit të rivlerësimit duket të jetë më e lartë se vlera e tregut<sup>12</sup>; (iv) Duket se subjekti ka përfutur kredinë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**17.7.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, z. Mane, lidhur me shumën 1.700.000 lekë, ka parashtruar se: (i) Babai i tij ka krijuar të ardhura të tjera të ligjshme, përveç pensionit të pleqërisë, konkretisht: *është angazhuar si pranë kompanive private, por edhe pranë institucioneve publike*, duke paraqitur dokumentacion vetëm për Shoqërinë Tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k, e cila ka konfirmuar me shkrim disa herë, që në vitin 2016, pjesëmarrjen e babait të subjektit pranë kësaj kompanie, në cilësinë e Drejtuesit Teknik. (ii) Prindërit e subjektit, konkretisht nëna, \*\*\* Mane, në datën \*.1.1994, ka blerë nga ish-Ndërmarrja Komunale Banesa, një objekt (zyrë), me sipërfaqe 12 m<sup>2</sup>. Ky objekt, pra zyra bashkë me truallin, është shitur në vitin 1996, te shtetasi \*\*\*.\*\*\*, me çmimin prej 500.000 lekë. Shitja është materializuar me kontratën nr. \*\*\*/\*\*\*, datë \*.12.1996. Kështu, duke përfshirë në analizën financiare këtë të ardhur, përmbysset plotësisht pamundësia financiare prej 463.016 lekë. Në vijim, subjekti ka paraqitur pretendimet edhe lidhur me konstatimet e tjera të Komisionit, në përgjigje të barrës së provës<sup>13</sup>.

**17.8.** Komisioni, në përfundim, pasi ka marrë në analizë shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në këto përfundime: (i) Nga analiza financiare e përfunduar nga Komisioni rezultoi se prindërit e subjektit kishin mundësi financiare nga burime të ligjshme për dhënien e shumës 1.700.000 lekë, subjektit të rivlerësimit dhe

<sup>10</sup> Shkresa nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*.6.2022.

<sup>11</sup> Lidhur me të ardhurat e prindërve të subjektit ka kryer analizën financiare, nga ku duket se prindërit e subjektit nuk kishin burime të mjaftueshme financiare për përballimin e shpenzimeve të jetesës dhe dhënien e vlerës së deklaruar, prej 1,700,000 lekësh, subjektit, në datën \*.2.2013, pasi rezultuan me pamundësi të ardhurash të ligjshme, në shumën 463,016 lekë. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni u përfshinë vetëm të ardhurat nga pensionet e përfuturuar ndër vite nga prindërit e subjektit. Të ardhurat e pretenduara të babait të subjektit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk janë përfshirë në analizë financiare, për arsye se nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore përkatëse.

<sup>12</sup> Pas një vlerësimi lidhur me vlerën e tregut për apartamentin në qytetin e Beratit, Komisioni ka konstatuar se duket që subjekti i rivlerësimit u ka shitur prindërve pjesën e tij takuese të pasurisë *banesë dhe truall*, me një vlerë më të lartë, sesa vlera e tregut në vitin 2013.

<sup>13</sup> Referohuni shpjegimeve të subjektit në parashtrimet e datës 2.12.2022, në dosjen e Komisionit.

përballimin e shpenzimeve të jetesës<sup>14</sup>. (ii) Veprimet e subjektit dhe prindërve të tij nuk kanë qenë veprime fiktive, por veprime juridike të kryera midis tyre, për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare<sup>15</sup>. (iii) Palët, në të dyja këto kontrata, kanë caktuar çmimin e njëjtë të shitjes së pasurisë *apartament* me vullnetin e lirë të tyre. Subjekti ka qenë koherent në deklarin e kësaj pasurie dhe burimit të krijimit që nga deklarata periodike, Deklarata *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorit. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur asnjë çështje penale me palën shitëse të pasurisë (si për shoqërinë dhe për ortakët e saj). Gjithashtu, në këtë godinë, ku ndodhet pasuria *apartament*, e blerë nga subjekti, ekzistojnë dhe apartamente të tjera të blera nga individë të ndryshëm, me vlerë më të vogël se vlera e blerjes nga ana e subjektit. Në përfundim, trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk ekziston ndonjë trajtim preferencial ndaj subjektit apo konflikt interesi me palën shitëse për blerjen e pasurisë *apartament*, në qytetin e Fierit<sup>16</sup>. (iv) Baza ligjore e përfitimit të kredisë është ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, si dhe VKM-ja nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, të ndryshuar. Sipas kësaj VKM-je, funksionarët publikë (ku përfshihet edhe kategoria e gjyqtarëve dhe prokurorëve) që kanë nevojë për strehim a sipërfaqe banimi shtesë u lind e drejta të kërkojnë trajtim me kredi, me kushte lehtësuese, nga shteti. Për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës, që, në kuptim të këtij vendimi, nënkupton territorin e rrethit ku ndodhet selia administrative e organit, ku subjekti kryen funksionin a ushtron detyrën. Sipas këtij vendimi, me nevojën për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, sipas këtij vendimi, do të nënkuptohet rasti kur subjekti nuk disponon ose disponon më pak sipërfaqe banimi se kuota minimale. Vlera e caktuar për përfitimin e kësaj kredie ishte deri në masën 5,000,000 lekë. Sipas kësaj VKM-je, subjektet përfituese nuk duhet të kishin pronësi banesë apo pasuri të tjera, që përdoren për veprimtari ekonomike në vendin e ushtrimit të detyrës etj. Përzgjedhja e përfituesve të kredisë bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara dhe ndiqen nga strukturat përkatëse shtetërore, që shqyrtojnë kërkesat për kredi për strehim<sup>17</sup>. (v) Komisioni ka kryer analizën e re financiare lidhur me mundësinë e pagesës së këstit prej 1,650,000 lekësh në vitin 2013, duke përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme shumën 1.700.000 lekë, dhënë nga prindërit e subjektit. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e këstit të apartamentit, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën<sup>18</sup>.

**17.9.** Komisioni, për pasurinë *apartament* me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*”, qyteti Fier, në përfundim të hetimit administrativ të kryer, nuk ka konstatuar problematika<sup>19</sup>.

**17.10. Komisioneri Publik** e gjen të pabazuar në akte vlerësimin e Komisionit lidhur me sa vijon:

**17.10.1. (i)** Lidhur me mundësinë e mbulimit me të ardhura të ligjshme të shumës 1.700.000 lekë, dhënë subjektit nga prindërit e tij dhe, si rrjedhojë, edhe mbulimin me burime të ligjshme të pagesës së këstit të apartamentit me sip. 140 m<sup>2</sup> në shumën 1.650.000 lekë<sup>20</sup>. Lidhur me mundësinë e mbulimit me të ardhura të ligjshme të shumës 1.700.000 lekë, dhënë subjektit nga prindërit e tij, nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, konstatojmë se Komisioni ka analizuar të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit për periudhën 1993 -\*\*2.2013, nga ku ka rezultuar një diferencë pozitive në vlerën 22.756 lekë<sup>21</sup>. Në këtë analizë nuk rezulton

<sup>14</sup> Shihni f.17 të vendimit.

<sup>15</sup> Shihni f.18 të vendimit.

<sup>16</sup> Shihni f.18 të vendimit.

<sup>17</sup> Shihni f.19 të vendimit.

<sup>18</sup> Shihni f.19 të vendimit.

<sup>19</sup> Referohuni arsytimit të Komisionit, në f.19 të vendimit.

<sup>20</sup> Kjo vlerë nuk përputhet me vlerën prej 1.750.000 lekë, të paguar me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2013.

<sup>21</sup> Referohuni analizës së Komisionit, në f.17 të vendimit.

të jetë përfshirë investimi i kryer nga prindërit e subjektit për blerjen e një apartamenti në Tiranë, në vitin 2004, në vlerën 61.946 euro (ekuivalenti në lekë rreth 8.000.000 lekë<sup>22</sup>), çka do të sillte pamjaftueshmëri në vlerën e blerjes së apartamentit.

**17.10.2.** Sa më sipër, në kushtet kur në vitin 2004 prindërit e subjektit kanë kryer një investim që është dukshëm në një vlerë më të lartë krahasuar me të ardhurat e realizuara prej tyre deri në vitin 2004, vlerësojmë se, për të analizuar mbulimin me burime të ligjshme të shumës 1.700.000 lekë, dhënë subjektit të rivlerësimit, duhen llogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës së prindërve të subjektit, për periudhën mars 2004 - dhjetor 2012, si edhe investime/depozita bankare të prindërve të subjektit, të kësaj periudhe<sup>23</sup>.

**17.10.3.** Nga aktet në dosje rezulton se, gjatë kësaj periudhe, prindërit e subjektit kanë përfutuar të ardhura nga pensionet, që llogariten në total në shumën rreth 3.200.000 lekë, ndërsa shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë janë në vlerën 2.429.827 lekë.

**17.10.4.** Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë subjektit shumën 1.700.000 lekë në vitin 2013 dhe, si rezultat, subjekti dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën e kështit në shumën 1.650.000 lekë, në vitin 2013.

**17.10.5.** Gjithashtu, Komisioneri Publik çmon të theksojë edhe rrethanat faktike të dala nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, si vijon:

**17.10.5.1.** Referuar përgjigjes me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.7.2022, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, subjekti Genci Mane rezulton bashkëpronar, në pasuritë me nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*<sup>24</sup>, së bashku me prindërit dhe vëllanë. Këto pasuri duket të jenë rivlerësuar në vitin 2017 dhe vlera e tyre, pas rivlerësimit, është 2.614.791 lekë, nga ku pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit llogaritet në vlerën 653.697 lekë. Pra, subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë marrë nga prindërit e tij një vlerë disa herë më të lartë, se vlera e tregut për pjesën e tij takuese, por pa vërtetuar mënyrën e kalimit të kësaj shume.

**17.10.5.2.** Sikurse është konstatuar dhe nga Komisioni, apartamenti me sip. 140 m,<sup>2</sup> i blerë nga subjekti në vitin 2013, sipas Entit Kombëtar të Banesave, llogaritet në vlerën 8.534.610 lekë, ndërsa subjekti e ka blerë këtë pasuri në vlerën 4,650,000 lekë, pra më pak se vlera e tregut.

**17.10.5.3.** Bazuar në mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë \*\*.3.2013, dhe vërtetimin nr. Extra prot., datë \*\*.6.2022, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*”, rezulton se subjekti ka paguar këstin e parë në vlerën 1.750.000 lekë, në datën \*\*.3.2013, që daton pas lidhjes së kontratës së shitjes (nr. \*\*\*/\*\*, datë \*\*.2.2013) dhe bie në kundërshtim me deklarin e subjektit në DV-2009, ku është deklaruar pagesa në vlerën 100.000 lekë. Kjo shumë duhet të merret në konsideratë në analizën financiare të pagesave të subjektit për apartamentin.

**17.10.5.4.** Gjithashtu konstatohet se Furnizuesi i Shërbimit Universal, me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.6.2022, ka konfirmuar se: (1) me gjeneralitetet Genci \*\*\* Mane identifikohet një abonent me kontratë të furnizimit nr. \*\*\*, në instancën Fier dhe (ii) me gjeneralitetet Genci Mane (pa atësi) identifikohet një abonent me kontratë të furnizimit nr. \*\*\*, në instancën Fier. Rezulton se të dyja këto kontrata janë lidhur në vitin 2011, përkatësisht në kabinën “\*\*\*\* \*\*\*\*” dhe “\*\*\*\* \*\*\*\*”. Nga aktet në dosje konstatohet se nuk është hetuar/kërkuar informacion në lidhje me kontrata të furnizimit midis subjektit dhe personave të lidhur, me Shoqërinë e Ujësjellës-Kanalizime SHA Fier.

<sup>22</sup> Referohuni kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 9.3.2004.

<sup>23</sup> Referuar akteve në dosjen hetimore, konstatohet që Komisioni nuk ka hetuar/pyetur bankat e nivelit të dytë për llogari bankare në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit.

<sup>24</sup> Referuar kësaj shkrese rezulton se këto pasuri janë mbyllur dhe është hapur një pasuri nr. \*\*\*/\*\*\*.



**17.10.5.5.** Lidhur me kredinë e miratuar nga \*\*\*, Dega Fier, për subjektin e rivlerësimit, arsyetimi i Komisionit është përqendruar në referencë të vendimit nr. 600, datë 1.9.2007, të Këshillit të Ministrave: “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, ndërkohë që miratimi i kredisë është në kuadër të projektit të pastrehëve të Bashkisë Fier.

### **III.B Çështje të tjera për vlerësim të përgjithshëm**

#### **18. Përdorimi i automjeteve në pronësi të të tretëve**

**18.1.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim<sup>25</sup> automjete në pronësi të të tretëve dhe, më konkretisht: (i) automjetin e markës *Mercedes Benz*, modeli *E320 CDI*, me targë: \*\*\*, automjetin e markës *Mercedes Benz*, modeli *ML 280 CDI*, me targë: \*\*\*, në pronësi të shtetasit \*\*\*.\*\*\*; (ii) automjetin e markës *Volkswagen*, modeli *Jeeta*, me targë: \*\*\*, në pronësi të shtetasit \*\*\*.\*\*\*; (iii) automjetin me targë: \*\*\*, në pronësi të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, automjetin me targë: \*\*\*, në pronësi të shtetasit \*\*\*.\*\*\*; (iv) automjetet më targa të huaja: \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*. Për efekt të përdorimit të automjeteve, listuar në pikën (i), me targë: \*\*\* dhe pikën (ii), subjekti i rivlerësimit: *ka prerë tri polica sigurimi (TPL)*. Nga verifikimi i akteve në dosjen e Komisionit, konkretisht të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS, konfirmohet se subjekti dhe/ose familja e tij ka kaluar kufirin shqiptar me këto automjete në rreth 17 raste,<sup>26</sup> në periudhën prej vitit 2012 deri në maj të vitit 2022, i padeklaruar përdorimi i automjeteve në deklaratimet periodike të viteve të mëparshme dhe në D-Vetting. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti, z. Mane, në përgjigje të pyetjeve të drejtuara në pyetësorin standard dhe pyetësorin e datës 8.6.2022, konfirmon përdorim e automjeteve të listuara nga (i) deri (iii), pa deklaruar ato të listuara në pikën (iv). Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, përgjigjet se përdorimin e automjeteve e ka pasur të përkohshëm, kryesisht për dalje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe se këta shtetas janë persona që, në dijeni të tij (*subjektit të rivlerësimit*) kanë sjellje dhe qëndrim të mirë shoqëror dhe se nuk ka ndjekur çështje penale në ngarkim të tyre. Nga informacione që aksesohen në burime “*open sources*”<sup>27</sup> rezultojnë dy episode me të dhëna problematike në drejtim të shtetasve, me të cilët subjekti, z. Mane, ka marrëdhënie shoqërore dhe ka përdorur automjetet e tyre. Referuar korrespondencës me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit,<sup>28</sup> rezulton edhe një gjobë e datës \*\*.9.2021, për automjetin me targë: \*\*\*, me kundërvajtës personin e lidhur, znj. \*\*\*.

**18.2.** Për sa trajtuar më lart, për efekt të përdorimit të këtyre automjeteve, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaratimit të pasaktë e të pamjaftueshëm për sa parashikon neni D, pika 1 e aneksit të Kushtetutës, dhe neni 3, pika 11<sup>29</sup> e ligjit nr. 84/2016, lidhur me mosdeklarimin e interesit pasuror në formën e përdorimit të automjeteve, situatë kjo që, po ashtu, afekton edhe në drejtim të vlerësimit të standardit të integritetit dhe etikës së magjistratit prokuror.

#### **19. Çështje të lidhura me vlerësimin profesional**

**19.1.** Denoncim nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, i cili pretendon veprime antiligjore nga subjekti i rivlerësimit. Për vlerësimin e denoncimit, Komisioni ka administruar dosjen 3 lidhur me

<sup>25</sup> “<sup>16</sup> Siç rezulton nga kontrolli i regjistrit të sistemit TIMS, të dhënat e policave të sigurimit pranë AMF, përcjellë Komisionit në kuadër të hetimit të kryer lidhur me subjektin e rivlerësimit.”

<sup>26</sup> 11 raste me automjetin me targa: \*\*\*.

<sup>27</sup> [https://www.arkivalajmeve.com/Sekuestrohet-nje-automjet-luksoz-i-vjedhur-ne-Britani.\\*\\*\\*/](https://www.arkivalajmeve.com/Sekuestrohet-nje-automjet-luksoz-i-vjedhur-ne-Britani.***/)

<http://www.panorama.com.al/te-dehur-ne-timon-dhe-pa-patente-ne-pranga-13-drejtuues-automjetesh/>

<sup>28</sup> Shkresa me nr.\*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.10.2022.

<sup>29</sup> “11. ‘Pasuri’ janë të gjitha pasuritë e luajshme dhe të paluajshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, të ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.”

procedimin penal nr. \*\*\*, muaji maj 2020, nga shqyrtimi i së cilës, në mënyrë të përmbledhur, rezultojnë këto rrethana:

**19.1.1.** Subjekti i rivlerësimit, prokurori i çështjes, më datë \*\*.5.2020, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale: “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236, paragrafi 2 i Kodit Penal<sup>30</sup>, si dhe shënimin në regjistër, të emrit të shtetasit \*\*\*.\*\*\*. Në dosjen e përcjellë pranë Komisionit, rezulton se, me vendimin e datës \*\*.8.2020, pasi përshkruhet kryerja e veprimeve hetimore të këqyrjes së pamjeve filmike të regjistruara nga një subjekt privat dhe pyetjen e punonjësve të policisë (të cilët kanë ndaluar e shoqëruar denoncuesin dhe nuk kanë deklaruar përdorim dhune nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*) është vendosur shtyrja e afateve të hetimit, deri më datë \*\*.11.2020. Me njoftimin e dorëzuar më datë \*\*.10.2020 është njoftuar përfundimi i hetimeve.

**19.1.2.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, me vendimin nr. \*\*, të datës \*\*.1.2021, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë Fier, me objekt: dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2020, me të pandehur shtetasin \*\*\*.\*\*\*, akuzuar për veprën penale: “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë, duke urdhëruar të plotësojë hetimet, si dhe përfundimin e hetimeve të ngarkuara nga Gjykata deri më datë \*\*.2.2021.

**19.1.3.** Rezulton se, me vendimet e datës \*\*.10.2021, \*\*.1.2022 dhe \*\*.4.2022, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, ka marrë vendimet për shtyrjen e afateve të hetimit për këtë procedim penal dhe, më datë \*\*.7.2022, çështja është dërguar për gjykim.

**19.1.4.** Komisioni, pasi ka përshkruar vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, filluar me ankimin e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, ku në përfundim ka vendosur arkivimin e çështjes, ka arritur në përfundimin se: *nuk rezultuan indicie për shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimit nga ky denoncim dhe ndodhemi përpara gjësë së gjykuar*<sup>31</sup>.

**19.1.5.** Komisioneri Publik, në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2020, ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, në raport me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim për rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, nenet 71 – 74 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, ndan qëndrim të ndryshëm me përfundimin e arritur nga Komisioni. Mangësitë e vërejtura duken të natyrës përsëritëse në drejtim të ndërmarrjes së hetimeve logjike dhe efektive, si dhe në respektim të urdhërimeve të lëna nga gjykata, si dhe të mangëta për sa i përket kualifikimit, sipas paragrafit 2, të nenit 236, të Kodit Penal, ku si elemente të anës objektive paraqiten: bashkëpunimi, dhuna fizike apo përsëritja më shumë se një herë, të cilat nuk rezultojnë sipas akteve në dosje të fashikullit penal. Po ashtu, Komisioni është i paqartë dhe i pashpjegueshëm lidhur me konsideratën se: *“ndodhemi përpara gjësë së gjykuar”*.

**19.2.** Denoncim i shtetasit \*\*\*.\*\*\*<sup>32</sup>, ky shtetas pretendon, ndër të tjera, zvarritje të hetimit pa arsye ligjore, mosnjoftim të shtyrjes së hetimeve nga subjekti i rivlerësimit, si dhe *dyshime mbi lidhjen e subjektit të rivlerësimit me krimin e organizuar, pasi dhe mjeti që përdor çdo ditë për të shkuar në punë, me targa: \*\*\*, është në pronësi të \*\*\*.\*\*\*, subjekt i SPAK...*, duke kërkuar të bëhen hetime, pasi provat janë shumë të qarta. Për vlerësimin e këtij denoncimi, Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, kopje të

---

<sup>30</sup> Neni 236, “Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik”, I. Kundërshtimi që i bëhet punonjësit të policisë së rendit publik, me qëllim për ta penguar atë për kryerjen e detyrës sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. **2. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.**

<sup>31</sup> Shihni f. 40 të vendimit.

<sup>32</sup> Ankesa është paraqitur edhe pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, organe të cilat, pas analizimit të shkeljeve të mundshme të subjektit të rivlerësimit, kanë vlerësuar se për subjektin e rivlerësimit nuk rezultuan fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit për kryerje të shkeljeve disiplinore dhe as ndonjë shkelje tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe, përkatësisht, me vendimin nr. \*\*\*/\*\* extra prot., datë \*\*.5.2022, dhe nr. \*\*\*/\*\*, datë \*\*.2.2021, kanë vendosur arkivimin e ankesës.

fashikullit të procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.4.2020, nga shqyrtimi i së cilës, në mënyrë të përmbledhur, kanë rezultuar këto rrethana:

**19.2.1.** Më datë \*\*.4.2020<sup>33</sup> është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, për veprat penale të parashikuara nga neni 150, 84, 25 dhe 274/1, 25 të kodit Penal, si dhe shënimin në regjistër të emrit të shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, si persona të cilëve u atribuohet veprat penale të parashikuara nga neni 84, 25 dhe \*\*\*; në të njëjtën datë është bërë kërkesa për vleftësim të arrestit në flagrancë<sup>34</sup> dhe caktimin e masës së sigurimit “*arrest me burg*” dhe “*detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, me vendim nr. \*\*\*, datë \*\*.4.2020. Më datë \*\*.5.2020, prokurori, subjekti i rivlerësimit, ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore nga OPGJ, me afat datën \*\*.6.2020. Më datë \*\*.7.2020 është marrë deklaram i shtetasit të dëmtuar \*\*\*.\*\*\*, si dhe është mbajtur dhe procesverbali për tërheqjen nga ankimi. Më datë \*\*.12.2020, prokurori ka urdhëruar delegimin e kryerjes së veprimeve hetimore mbi komunikimin e njoftimit të akuzës, pyetjes së të pandehurit, komunikimin e aktit të përfundimit të hetimeve, pa përcaktuar një datë për kryerjen e veprimeve. Në të njëjtën datë është hartuar vendimi për marrjen e \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e personit të pandehur dhe është bërë njoftimi i akuzës, komunikuar më datë \*\*.2.2021<sup>35</sup>. Në të njëjtën datë është bërë pyetja e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e personit të pandehur dhe njoftimi i përfundimit të hetimeve, hartuar nga prokurori, duke i bashkëlidhur akteve letrën e të drejtave, nënshkruar nga i pandehuri. Më datë \*\*.2.2021, nga i pandehuri, nëpërmjet avokatit të tij, është kërkuar kopje e akteve, dërguar nga prokurori datë \*\*.3.2021. Shtetasi \*\*\*.\*\*\* është pyetur në cilësinë e të pandehurit nga OPGJ, sipas procesverbalit të datës \*\*.2.2021, i është komunikuar njoftimi për përfundimin e hetimeve, pa një datë të plotë të aktit, por vetëm viti, 2021, dhe të datës së komunikimit. Gjithashtu, procesverbali për njohjen e viktimave me të drejtat nuk rezultoi të ketë një datë të caktuar, veç vitit, 2021. Në vazhdim, në datën \*\*.3.2021, është përgatitur kërkesa për gjykimin e procedimit penal, njoftuar palëve me shkresën e datës \*\*.1.2021, në të njëjtën datë është njoftuar dhe vendimi i pushimit të procedimit penal.

**19.2.2.** Mbi këtë procedim penal është marrë vendim për zgjatjen e afateve të hetimit në datat \*\*.7.2020, \*\*.10.2020 dhe \*\*.1.2021. Nga aktet në dosjen e Komisionit nuk rezultojnë akte që provojnë komunikimin e përfundimit të hetimeve viktimës. Kontrolli gjyqësor i këtij procedimi penal është konfirmuar nga gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë, Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2021.

**19.2.3.** Komisioni, pasi ka përshkruar vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, filluar me ankimin e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, ku në përfundim ka vendosur arkivimin e çështjes, ka arritur në përfundimin se: *nuk rezultuan indicie për shkëlqje të mundshme të subjektit të rivlerësimit nga ky denoncim dhe ndodhemi përpara gjësë së gjykuar*.<sup>36</sup>

**19.2.4.** Komisioneri Publik, në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2020, ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, në raport me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim për rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, nenet 71 – 74 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, ndan qëndrim të ndryshëm me përfundimin e arritur nga Komisioni. Kështu, në asnjë nga vendimet e zgjatjes së afateve të hetimit, nuk është përcaktuar lloji i veprimeve hetimore që do të kryhen, vendime të cilat, nga përmbajtja e akteve në dosjen e Komisionit, nuk rezultojnë<sup>37</sup> t’u jenë njoftuar të dëmtuarit dhe të pandehurve. Po ashtu, Komisioni është i

<sup>33</sup> Në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, datë \*\*.4.2020, nënshkruar nga subjekti, urdhërohet regjistrimi i procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2019.

<sup>34</sup> Sipas procesverbalit për arrestimin në flagrancë, datë \*\*.4.2020, nënshkruar nga \*\*\*.\*\*\* dhe OPGJ.

<sup>35</sup> Sipas nënshkrimit të vendosur në aktin e njoftimit të akuzës, në dosjen e Komisionit.

<sup>36</sup> Shihni f. 42 të vendimit.

<sup>37</sup> Nga një “Informacion mbi procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2020”, pa datë, pa nënshkrim, në dosjen e Komisionit, rezultoi siç citojmë: “Vendimet e zgjatjeve të afateve hetimore u janë komunikuar të pandehurve nga O. P. Gjyqësore”.

paqartë dhe i pashpjegueshëm lidhur me konsideratën se: “*ndodhemi përpara gjësë së gjykuar*”.

**19.3.** Duke përfunduar për sa më sipër, bazuar në indikatorët vlerësues, të parashikuar nga nenet 71-74 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, për subjektin e rivlerësimit konstatohen disa raste me mangësi, të tilla që nuk pajtohen me pritshmërinë se prokurori duhet të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe ndërmarrjes së hetimeve të shpejta dhe të plota, të gjithanshme dhe objektive, me qëllim arritjen e një përfundimi të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe prova. Mangësitë e konstatuara në këtë kriter vlerësimi duhen vlerësuar së bashku dhe me problematikat e vërejtura në kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, të cilat mund të çojnë në një vlerësim të ndryshëm me atë të arritur nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**20.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

**21.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**22.** Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 598, datë 13.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit, zotit Genci Mane.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**